



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO



**KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS**  
TUŽILAČKI SAVET KOSOVA - KOSOVO PROSECUTORIAL COUNCIL

# **BULETINI** **MUJOR**



**Prishtinë, 2025**

**Ky edicion i Buletinit pasqyron  
aktivitetet e KPK-së për muajin mars të vitit 2025**

## Mbahet Takimi i 263-të i Këshillit Prokurorial të Kosovës

Prishtinë, 3 mars 2025 – Këshilli i Prokurorial i Kosovës (KPK), i udhëhequr nga Kryesuesi Ardian Hajdaraj, mbajti Takimin e 263-të, me ç’rast mori vendimet si në vijim:



1. Miratoi Rregulloren për Themelimin dhe Funksonimin e Ekipeve të Përbashkëta të Hetimit;
2. Miratoi Rregulloren për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr.02/2023 për Veprimtarinë, Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Administratës së Këshillit Prokurorial të Kosovës;
3. Miratoi Raportin tremujor për periudhën tetor-dhjetor 2024 për aktivitetet dhe rekomandimet e Koordinatorit Kombëtar për Luftimin e Krimeve Ekonomike;
4. Miratoi Raportin vjetor të mekanizmit përcjellës ndërinstitucional për veprat penale karakteristike për vitin 2024;
5. Miratoi pensionimin e prokurorit Besim Susuri në Prokurorinë Themelore në Prizren, me ç’rast do t’ia dërgojë Presidentes propozimin për lirimin e tij nga detyra;
6. Miratoi dorëheqjen e parakohshme të prokurorit Agim Kurmehaj në Prokurorinë Themelore në Pejë për shkaqe shëndetësore, me ç’rast do t’ia dërgojë Presidentes propozimin për lirimin e tij nga detyra;
7. Zgjodhi prokuroren e Prokurorisë së Apelit, Shehribane Selimi-Muçaj, në detyrën e anëtares së Komisionit për Buxhet dhe Financa të KPK-së;
8. Aprovoi shpalljen e konkursit për avancim të një prokurori në Departamentin për Krime të Rënda në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë dhe të një prokurori në Departamentin për Krime të Rënda në Prokurorinë Themelore në Prizren;
9. Zgjodhi prokurorin Labinot Jetishi në detyrën e Zëvendësit të Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren, me mandat katërvjeçar me mundësi rizgjedhjeje edhe për një mandat dhe

10. Autorizoi Komisionin për Çështje Normative që të bëjë plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për Themelimin dhe Funksionalizmin e Koordinatorit Kombëtar për Luftimin e Krimeve Ekonomike.



## KPK dhe ZKPSH: Inkurajojmë dhe mbështesim Prokurorinë Speciale për realizimin e detyrave dhe përgjegjësiwe ligjore të saj për të fuqizuar rendin dhe ligjin në vendin tonë

Prishtinë, 4 mars 2025

Me rastin e deklaratave të sotme publike, të dhëna nga Kryeministri Albin Kurti, për mosparaqitjen e tij në Prokurorinë Speciale për të dhënë dëshmi në cilësinë e dëshmitarit, përkitazi me dyshimet për keqpërdorim të rezervave shtetërore, edhe pse Gjykata Themelore në Prishtinë kishte lëshuar urdhër për paraqitjen e tij në prokurori, Këshilli Prokurorial dhe Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, rikujtojnë se zbatimi i ligjit nuk mund të keqinterpretohet sipas shijeve, interesave dhe nevojave ditore të Kryeministrit në detyrë, duke dhënë deklarata jashtë parimeve bazë të sundimit të ligjit në Republikën e Kosovës.



Sipas KPK-së dhe Prokurorit të Shtetit, këto deklaratime përbëjnë vetëm pikëpamje dhe botëkuptime personale që ka ai për sundimin e ligjit, sepse veprimet për zbatimin e ligjit janë detyrim, jo vetëm për sistemin prokurorial, por edhe Kryeministrin, Qeverinë, por edhe për cilindo institucion tjetër dhe qytetar të vendit.

KPK dhe ZKPSH, potencojnë se deklaratat e dhëna në vazhdimësi nga Kryeministri Kurti e dëmtojnë seriozisht funksionimin e institucioneve demokratike dhe kanë për qëllim minimin e angazhimit të Prokurorit të Shtetit në përpjekjet për forcimin e sundimit të ligjit në Republikën e Kosovës.

Pa marrë parasysh përpjekjet për degradimin e organeve kushtetuese nga ana e Kryeministrit Kurti, KPK dhe Prokurori i Shtetit inkurajojnë dhe mbështesin fuqishëm Prokurorinë Speciale për realizimin e detyrave dhe përgjegjësiwe ligjore të saj, siç janë hetimi, ndjekja dhe ndriçimi i secilit rast penal që bie në kompetencë të saj, me qëllim të ngritjes së moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit në vendin tonë.

## Mbahet takimi i parë i Grupit punues për hartimin e draftit të Udhëzimit Administrativ për Caktimin e Normës Orientuese për Prokurorët e Shtetit

Prishtinë, 4 mars 2025 – Në kuadër të angazhimeve të shtuara të Këshillit Prokurorial të Kosovës për hartimin e akteve të standardizuara nënligjore, Grupi punues për hartimin e draftit të Udhëzimit Administrativ për Caktimin e Normës Orientuese për Prokurorët e Shtetit, i kryesuar nga Prokurori në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, Bahri Hyseni, në përbërje të të cilit janë anëtarët e KPK-së: Veton Shabani dhe Visar Krasniqi, si dhe Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore të Gjakovës, Enis Gashi, mbajti takimin e parë të tij.



Me këtë rast, z. Bahri Hyseni, theksoi se qëllimi i takimit të sotëm është diskutimi fillestar për hartimin e draftit të Udhëzimit Administrativ për Caktimin e Normës Orientuese, me të cilin përcaktohet norma orientuese vjetore për kryerjen e lëndëve për prokurorët e departamenteve të të gjitha prokurorive që funksionojnë në vendin tonë.

Më tej, ky grup punues trajtoi aktet që janë aktualisht në fuqi, të cilat kanë të bëjnë me caktimin e normës orientuese dhe në vijim zhvilloi diskutime për konceptin dhe metodologjinë hartuese të këtij akti të rëndësishëm normativ mbi bazën e standardeve dhe praktikave më të mira.



## Lansohen ekipet e përbashkëta të hetimit

Prishtinë, 6 mars 2025 – Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, Ardian Hajdaraj, Kryeprokurori i Prokurorisë Speciale, Blerim Isufaj dhe Zëvendëskryeprokurori i Prokurorisë Speciale, Valdet Gashi, morën pjesë në shënimin e njëvjetorit të projektit të Ambasadës Britanike, i cili zbatohet nga Sustainable Criminal Justice Solutions (SCJS), me qëllim të forcimit të policimit të drejtuar nga intelijenca dhe mbështetjen e krijimit të ekipeve të përbashkëta hetimore kundër financave të paligjshme dhe krimit të organizuar në Kosovë.



Me këtë rast, Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, Ardian Hajdaraj, falënderoi Ambasadorin Britanik, Jonathan Hargreaves, për kontributin, ekspertizën e ofruar nga ekspertët dhe mbështetjen e pakursyer, të cilat, sipas tij, ishin thelbësore për të siguruar cilësinë, përmbajtjen e saktë dhe përputhjen me standardet më të larta ndërkombëtare të Rregullores për Themelimin dhe Funksionimin e Ekipeve të Përbashkëta të Hetimit, si dhe vlerësoi lart bashkëpunimin, falë të cilit do të fuqizohen kapacitetet e Prokurorisë Speciale dhe Policisë së Kosovës për të hetuar veprat komplekse. Ndër të tjera, z. Hajdaraj, tha: “Jam besimplotë që ky bashkëpunim do të forcojë kapacitetet e Prokurorisë Speciale dhe Policisë së Kosovës për të hetuar veprat komplekse që konsiderohen të rëndësishme për përfshirje në ekipet e përbashkëta të hetimit në përputhje me standardet dhe praktikën e mira ndërkombëtare. Në këtë drejtim, tërë puna, profesionalizmi dhe përkushtimi i ekspertëve në hartimin e Rregullores për Themelimin dhe Funksionimin e Ekipeve të Përbashkëta të Hetimit është kurorëzuar me miratimin e kësaj rregulloreje nga KPK-ja para tri ditëve, e cila tash ka karakter detyrues në zbatimin e saj dhe do të jetë lehtësim për punën hetimore të Prokurorisë Speciale”.

Nga ana tjetër, z. Jonathan Hargreaves, Ambasadori Britanik në Prishtinë, ka vlerësuar në mënyrë të veçantë përkushtimin e institucioneve përkatëse për të forcuar demokracinë dhe efikasitetin e sistemit të drejtësisë, me ç'rast tha: “Ju jeni ata që mbani përgjegjësinë për të mbrojtur të drejtat dhe për të ruajtur një nga shtyllat më të rëndësishme të demokracisë – pavarësinë dhe efikasitetin e institucioneve.



Dhe gjithmonë më ka bërë përshtypje mënyra se si ju, në Kosovë, e realizoni këtë mision. Sigurisht, ka ende punë për të bërë, siç e dimë nga disa nga raportet e BE-së dhe organizatave të tjera ndërkombëtare, me të cilat jeni të njohur edhe ju, ashtu siç jam edhe unë. E di që po punoni me përkushtim për çështjet e ngritura në ato raporte. Por, gjithashtu e di që po e bëni këtë me synimin për të forcuar më tej demokracinë”.

Në këtë ngjarje kanë mbajtur fjalë rasti edhe Drejtori i Policisë së Kosovës, Gazmend Hoxha dhe përfaqësuesit e Doganës dhe Administratës Tatimore të Kosovës.

Kësaj ngjarjeje i kanë paraprirë nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet të Këshillit Prokurorial të Kosovës, Policisë së Kosovës dhe Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar dhe Irlandës së Veriut e përfaqësuar nga Ambasada Britanike në Prishtinë dhe miratimi nga ana e KPK-së më 3 mars 2025 i Rregullores për Themelimin dhe Funksionimin e Ekipeve të Përbashkëta të Hetimit.



## Kryesuesi i Komisionit për Administrimin e Prokurorive priti në takim përfaqësuesit e CEPEJ-it dhe Zyrës së BE-së në Kosovë

Prishtinë, 6 mars 2025 - Kryesuesi i Komisionit për Administrimin e Prokurorive në KPK, Jetish Maloku, priti në takim Kryeprokurorin e Mons-Tournait nga Belgjika, Vincent Macq, njëherësh ekspert i CEPEJ-it, ekspertin e CEPEJ-it, Stephanie Lefeuvre dhe Udhëheqësin e Ekipit për Sundimin e Ligjit dhe të Drejtave Themelore në Zyrën e Bashkimit Evropian në Kosovë, Nicola



Qëllimi i takimit ishte diskutimi për avancimin e shabllonëve që gjenerohen nga Sistemin për Menaxhimin Informativ të Lëndëve dhe identifikimi i sfidave aktuale gjatë përdorimit të këtyre shablloneve në SMIL.

Më këtë rast, z. Maloku falënderoi për vizitën përfaqësuesit e CEPEJ-it dhe Zyrës së BE-së në Kosovë, si dhe i ka njoftuar ata për mbajtjen e punëtorisë që ka pasur në fokus të veçantë futjen e të dhënave të cilësisë së lartë në SMIL për të mundësuar ripërdorimin e tyre gjatë përgatitjes së dokumenteve ligjore.

Nga ana tjetër, z. Macq, ka nënvizuar rëndësinë e përdorimit të shabllonëve në punën e përditshme të prokurorëve dhe përballimin e sfidave gjatë përdorimit të tyre dhe adresimin e vështirësive, ndërsa në përfundim të takimit të sotëm është arritur pajtimi që të formohet një grup punues, i cili do të merret me avancimin e shabllonëve aktualë, me qëllim që të pasqyrohen në SMIL.



## Kryesuesi i Këshillit Prokurorial, Ardian Hajdaraj, pret në takim Shefen e Njësisë Korrektuese të EULEX-it, Anu Melkko

Prishtinë, 10 mars 2025 – Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, z. Ardian Hajdaraj, ka pritur në një takim shefen e Njësisë Korrektuese të EULEX-it, znj. Anu Melkko.



Gjatë këtij takimi, Kryesuesi Hajdaraj ka ndarë me znj. Melkko prioritetet dhe sfidat që po përballët sistemi prokurorial, si dhe ka theksuar arritjet që janë bërë për avancimin e sundimit të ligjit në Kosovë gjatë viteve të fundit. Ai ka vënë në pah përpjekjet e vazhdueshme të Këshillit Prokurorial të Kosovës për përmirësimin e efikasitetit, transparencës dhe forcimin e sistemit prokurorial.

Në anën tjetër, znj. Melkko ka njoftuar Kryesuesin Hajdaraj se është miratuar një projekt i EULEX-it për fuqizimin e bashkëpunimit në zinxhirin e drejtësisë. Ky projekt fokusohet në rritjen e përdorimit të dënimeve alternative dhe masave të diversitetit, si dhe në përmirësimin e kapaciteteve të institucioneve të Kosovës për rehabilitimin dhe ri-integrimin e kryesve të veprave penale. Projekti pritet të implementohet deri në qershor të vitit 2025.

Kryesuesi Hajdaraj ka theksuar gatishmërinë e Këshillit Prokurorial për të bashkëpunuar ngushtë në realizimin e këtij projekti, me qëllim të përmirësimit të kapaciteteve të institucioneve të Kosovës dhe avancimit të sistemit të drejtësisë.



## Mbahet takimi i radhës i Komisionit për Çështje Normative

Prishtinë, 10 mars 2025 – Komisioni për Çështje Normative i Këshillit Prokurorial të Kosovës, i udhëhequr nga kryetari Armend Zenelaj, mbajti takimin e radhës. Në këtë takim morën pjesë anëtarët Bahri Hyseni dhe Ilir Morina, Koordinator i Komisioneve të Përhershme të KPK-së, Besim Kusari, si dhe Udhëheqësja e Departamentit Ligjor në SKPK, Saranda Sokoli.



Në këtë takim, Komisioni shqyrtoi Planin Strategjik për periudhën 2025-2027, i cili ishte hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi. Pas shqyrtimit, Komisioni konstatoi se plani është përgatitur në përputhje me kërkesat ligjore dhe nuk ka pasur komente shtesë.



## Kryesuesi Hajdaraj dhe Kryeprokurori Isufaj ishin pjesë e takimit përmbyllës të projektit për Sundimin e Ligjit në Ballkanin Perëndimor (WBROLI)

Prishtinë, 12 mars 2025 – Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, Ardian Hajdaraj dhe Kryeprokurori i Prokurorisë Speciale, Blerim Isufaj, si dhe Zëvendëskryeprokurori i kësaj prokurorie, Valdet Gashi, ishin pjesë e takimit të sotëm përmbyllës të projektit për Sundimin e Ligjit në Ballkanin Perëndimor (WBROLI).



Me këtë rast, z. Hajdaraj dhe z. Isufaj falënderuan Ambasadorin Hargreave për mbështetjen e vazhdueshme të Mbretërisë së Bashkuar në fuqizimin e sundimit të ligjit dhe luftimin e krimit të organizuar.

Ky projekt është mbështetur nga Mbretëria e Bashkuar dhe ka shërbyer për forcimin e institucioneve të drejtësisë, duke përmirësuar bashkëpunimin rajonal.



## Mbahet Takimi i 264-të i Këshillit Prokurorial të Kosovës

Prishtinë, 13 mars 2025 – Këshilli i Prokurorial i Kosovës (KPK), i udhëhequr nga Kryesuesi Ardian Hajdaraj, mbajti Takimin e 264-të, me ç' rast:

1. Miratoi kërkesën e Autoritetit Kompetent të Prokurorisë Themelore të Prishtinës dhe themeloi Panelin Hetimor për një rast disiplinor;
2. Miratoi Raportin vjetor të punës së Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës për vitin 2024;
3. Miratoi Raportin vjetor të punës së Këshillit Prokurorial të Kosovës për vitin 2024;



4. Miratoi Raportin e Komisionit për Kushte të Tregut të Punës;
5. Caktoi prokurorin Agim Kuka në detyrën e Zëvendësit të Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Ferizaj, me mandat katërvjeçar me mundësi rizgjedhjeje edhe për një mandat dhe
6. Caktoi prokuroren Bahtije Ademi në detyrën e Zëvendësës së Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjiilan, me mandat katërvjeçar me mundësi rizgjedhjeje edhe për një mandat.





## Mbahet takimi i Komisionit për Çështje Normative

Prishtinë, 17 mars 2025 – Komisioni për Çështje Normative i Këshillit Prokurorial të Kosovës, i udhëhequr nga kryetari Armend Zenelaj, mbajti takimin e radhës, në të cilin morën pjesë anëtarët Bahri Hyseni, Jetish Maloku dhe Ilir Morina, si dhe Drejtori i Përgjithshëm i SKPK-së, Sami Istrefi, përfaqësuesit e Zyrës së BE-së në Prishtinë dhe stafi administrativ i Sekretariatit të KPK-së.



Më këtë rast, Komisioni për Çështje Normative analizoi draftin e sjellë nga grupi punues për hartimin e Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 02/2021 për Transferimin dhe Avancimin e Prokurorëve të Shtetit dhe vendosi që i njëjti të dalë në dëgjim publik sipas afatit të paraparë ligjor.

Më tej, anëtarët e Komisionit trajtuan edhe vendimin e Këshillit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Themelimin dhe Funksionalizimin e Koordinatorit Kombëtar, me ç'rast formuan një grup punues, i cili do të përgatisë një analizë dhe më pas do të vendosë për të bërë plotësimin dhe ndryshimin e rregullores aktuale apo draftimin e një rregulloreje të re.

## Miratohet Korniza Afatmesme të Shpenzimeve 2026-2028

Prishtinë, 19 mars 2025 – Në kuadër të takimeve të rregullta të komisioneve të përhershme të Këshillit Prokurorial të Kosovës, Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel, i cili udhëhiqet nga prokurorja Ariana Shajkovci, mbajti sot takimin e radhës.



Në këtë takim morën pjesë Visar Krasniqi (KPK), Iliriana Çollaku-Tafa (PSRK), Sheribane Selimi-Muçaj (PA), Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, Sami Istrefi, si dhe Udhëheqësja e Departamentit për Buxhet dhe Financa në SKPK-së, Suzana Pllana dhe Udhëheqësi i Divizionit për Buxhet, Astrit Zhubi.

Me këtë rast, anëtarët e Komisionit miratuan Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2026-2028, sipas propozimeve me disa ndryshime dhe plotësime.



## Mbahet takimi i radhës i Komisionit për Administrimin e Prokurorive

Prishtinë, 19 mars 2025 – Komisioni për Administrimin e Prokurorive, i kryesuar nga Jetish Maloku, mbajti takimin e radhës, në të cilin morën pjesë prokurorja Laura Pula (ZKPSH), prokurori Admir Shala (PSRK), Drejtoresha e NJSHPP-së, Arta Kelmendi dhe Udhëheqësi i Departamentit të Teknologjisë Informative në SKPK, Nexhat Haziri dhe Udhëheqës i Divizionit për Sisteme Elektronike, Ilir Hetemi.



Në takimin e sotëm është prezantuar analiza për numrin e nevojshëm të prokurorëve në Prokurorinë Themelore në Prishtinë dhe e njëjta është aprovuar dhe do të dërgohet për miratim në njërin nga takimet e radhës së Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Në vijim të takimit është formuar Grupi i përbashkët punues i KPK-së dhe Policisë së Kosovës për trajtimin e të gjeturave të identifikuara gjatë shkëmbimit elektronik të të dhënave dhe po ashtu është formuar edhe grupi punues për trajtimin dhe avancimin e shablloneve të SMIL-it.

Gjithashtu, anëtarët e këtij Komisioni miratuan edhe agjendën e planifikuar për të zhvilluar vizitat nëpër prokuroritë e vendit për monitorimin e zbatimit të SMIL-it dhe po ashtu janë prezantuar raporte statistikore, të cilat gjenerohen nga SMIL-i.





## Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të KPK-së, Sami Istrefi, mbajti ligjëratë për studentët e Fakultetit Juridik të Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë

Prishtinë, 26 mars 2025 - Me ftesë të Prof. Asoc. Dr. Agron Beka, studentët e Fakultetit Juridik të Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë patën mundësinë të ndjekin një ligjëratë të veçantë nga Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, z. Sami Istrefi.



Ligjërata e mbajtur në kuadër të lëndës “Bazat e sistemit të drejtësisë” trajtoi çështje kyçe mbi organizimin dhe funksionimin e sistemit të drejtësisë në Kosovë, me theks të posaçëm lidhur me rolin e administratës së sistemit prokurorial, si dhe me sfidat aktuale me të cilat ballafaqohet.

Gjatë prezantimit, Drejtori i Përgjithshëm, z. Sami Istrefi, ndau përvojën e tij profesionale dhe sqaroi aspektet praktike të menaxhimit dhe administrimit të sistemit prokurorial.

Studentët patën mundësinë të bëjnë pyetje dhe të diskutojnë për temat që ndërlidhen me funksionimin e institucioneve të drejtësisë në vend.

Kjo ligjëratë u vlerësua si një kontribut i çmuar në formimin akademik dhe profesional të studentëve, duke iu ofruar atyre një perspektivë praktike mbi temat e studiuar në kuadër të programit të tyre universitar.





## Mbahet takimi i Komisionit për Çështje Normative

Prishtinë, 27 mars 2025 – Komisioni për Çështje Normative, i kryesuar nga Armend Zenelaj, mbajti takimin e radhës, në të cilin morën pjesë prokurorët Bahri Hyseni dhe Ilir Morina, si dhe Koordinatori i Komisioneve të Përhershme, Besim Kusari.



Gjatë takimit të sotëm, pas elaborimit të analizës nga kryesuesi i grupit punues, prokurori Ilir Morina, Komisioni për Çështje Normative draftoi plotësimndryshimin e Rregullores për Themelimin dhe Funkcionalizimin e Koordinatorit Kombëtar për Krime Ekonomike dhe vendosi që i njëjti të publikohet për dëgjim publik në faqen zyrtare të KPK-së.

Në fund të këtij takimi është thënë se pas marrjes së komenteve eventuale nga dëgjimi publik dhe shqyrtimit të tyre për inkorporim, do të bëhet finalizimi i tërësishëm i këtij drafti dhe do të dërgohet për miratim në njërën nga takimet e KPK-së.



## Anëtari i KPK-së, Visar Krasniqi, merr pjesë në tryezën e organizuar nga GLPS-ja

Prishtinë, 27 mars 2025 – Në kuadër të prezantimit të gjetjeve kryesore nga monitorimi njëvjeçar i rasteve të korrupsionit në gjykatat themelore në Prishtinë, Pejë dhe Gjakovë, GLPS-ja në zbatim të projektit “Act Now”, i cili mbështetet nga BE-ja, mbajti një tryezë diskutimi me temën “Si i trajtuan gjykatat rastet e korrupsionit gjatë vitit 2024?”, në të cilën mori pjesë anëtari i Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), z. Visar Krasniqi dhe përfaqësues të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare.



Në fjalën e tij, z. Krasniqi në cilësinë e panelistit, tha se sistemi prokurorial është plotësisht i fokusuar për rritjen e efikasitetit dhe cilësisë së aktakuzave, duke vënë në dukje se nga viti 2013 e deri më sot, KPK-ja hartoi dhe miratoi dokumente të rëndësishme strategjike në kuadër të planifikimit të rritjes së efikasitetit në luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit. “Pra, në këtë drejtim, KPK-ja themeloi edhe Komisionin mbikëqyrës për monitorimin e rasteve të korrupsionit dhe krimeve ekonomike në të gjitha prokuroritë e vendit dhe Njësitin për Luftimin e Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, kurse Plani i fundit strategjik i sistemit prokurorial përfshin vitet 2025-2027, të cilin KPK-ja do ta miratojë në njërin nga takimet e radhës”, nënvizoi para të pranishmëve z. Krasniqi.

Krasniqi, potencoi edhe rëndësinë e bashkërendimit të KPK-së dhe KGJK-së për të trajtuar dhe analizuar rastet e gjykimit të korrupsionit dhe përqindjes së ulët të kalueshmërisë së aktakuzave për korrupsionin nëpër gjykata, sepse të njëjtit prokuror arrijnë t’i kalojnë aktakuzat e tyre nëpër gjykata deri në 90 %, ndërsa të lëndët e korrupsionit dukshëm më pak.

Kurse, në përfundim të fjalës së tij, z. Krasniqi përmendi angazhimin e vazhdueshëm të Këshillit Prokurorial për përmirësimin e luftës kundër korrupsionit dhe rritjen e efikasitetit të sistemit prokurorial në trajtimin e këtyre rasteve.

